



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 167/ 10 prot.

Datë 12.03.2026

V E N D I M
Nr. 395 / 2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.341/2026, datë 04.03.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-70522-11-27-2025, me objekt “Shërbim shtypshkrime dhe dokumentacion pune”, me fond limit: 1,468,550 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.12.2025 nga autoriteti kontraktor Albpetrol SH.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “Inpress” SHPK, me Nipt L52122014L, Adresa: Rr. “Siri Kodra”, ish-Blloku Magazinat, Tiranë.

Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, me Nipt. J72124001N, Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Kashar, Rruga “Iliria”, nr. 53, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Albpetrol SH.A.
Adresa: Selia Rruga Fier–Patos, km 7.

Subjekt i Interesuar Operatori ekonomik “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK, me Nipt K83018403B, Adresa: Lagjja “Liri Gero”, Rr. “Haxhi Kelmendi”, Nr.10, Fier.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Me Vendimin Nr. 341/2026, datë 04.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

- 1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK mbi arsyen e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-70522-11-27-2025, me objekt “Shërbim shtypshkrime dhe dokumentacion pune”, me fond limit: 1,468,550 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.12.2025 nga autoriteti kontraktor Albpetrol SH.A.*
 - 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-70522-11-27-2025, me objekt “Shërbim shtypshkrime dhe dokumentacion pune”, me fond limit: 1,468,550 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.12.2025 nga autoriteti kontraktor Albpetrol SH.A.*
 - 3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.*
 - 4. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertat, duke skualifikuar ofertën e operatorit “SECURITY SYSTEM LIÇAJ” SHPK dhe kualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK sipas konstatimeve të këtij vendimi.*
 - 5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë Komisionin mbi veprimet e ndërmarra në përputhje me këtë vendim.*
 - 6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifave financiare të paguara nga operatorët ekonomikë “Marketing & Distribution” SHPK dhe “Inpress” SHPK.*
 - 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 - 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën ardhur me Nr.1315/3 datë 09.03.2026 protokolluar me tonën me nr. 167/7, datë 11.03.2026, autoriteti kontraktor njofton, se pas njohjes me Vendimin Nr. 341/2026 datë 04.03.2026 të KPP-së, kreu rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt gjykimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën ardhur me Nr.1315/3 datë 09.03.2026 protokolluar me tonën me nr. 167/7, datë 11.03.2026, autoriteti kontraktor njofton se pas njohjes me Vendimin Nr. 341/2026 datë 04.03.2026 të KPP-së, kreu rivlerësim të procedurës së prokurimit.

II.1.1. Referuar shkresës sipërcituar, Komisioni kreu verifikimin e raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik nga ku konstatoi, se autoriteti kontraktor më datë 09.03.2026 ka kryer rivlerësim të ofertave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në zbatim të konstatimeve të vendimit të KPP-së.

II.2. Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor Albpetrol SH.A, ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-70522-11-27-2025, me objekt “Shërbim shtypshkrime dhe dokumentacion pune”, me fond limit: 1,468,550 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.12.2025 nga autoriteti kontraktor Albpetrol SH.A.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-70522-11-27-2025, me objekt “Shërbim shtypshkrime dhe dokumentacion pune”, me fond limit: 1,468,550 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.12.2025 nga autoriteti kontraktor Albpetrol SH.A

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Florent Zguro

